



Republika e Kosovës	Republika Kosovo	Republic of Kosovo
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS	SUDSKI SAVET KOSOVA	KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
Nr.Br.No.	01	166
DAT.DT.	08 . 05 - 2019	PRISHTINË - A

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA- KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Këshilli Gjyqësor i Kosovës bazuar në nenin 8 paragrafi 4 të Ligjit nr.06/L -009 për Ndërmjetësim dhe në bazë të nenit 7 paragrafi 1, nënparagrafi 1.24 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datën 8 maj 2019, miraton këtë:

RREGULLORE (Nr.04/2019)

PËR PROCEDURËN E NDËRMJETËSIMIT TË LËNDËVE TË GJYKATAVE

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

- Qëllimi i kësaj rregullore është që të rregullojë procedurën e referimit në ndërmjetësim të lëndëve nga gjykatat.
- Kjo rregullore zbatohet nga subjektet e përfshira në procesin e referimit siç janë gjyqtarët, referentët e ndërmjetësimit, ndërmjetësuesit dhe palët në procedurë.

Neni 2 Përkufizime

Shprehjet e përmendura në këtë rregullore, kanë kuptim sikurse në përkufizimet e parapara me nenin 3 të Ligjit për Ndërmjetësim, ndërsa për qëllimet e kësaj rregullore, shprehjet e tjera kanë këtë kuptim:

Referent për ndërmjetësim- nënkupton zyrtarin e gjykatës që administron me lëndët e referuara për ndërmjetësim nga gjykata dhe i cili mund t'i ndihmojë edhe palët në rastet e vet-inicuara;

Zyra për Ndërmjetësim - nënkupton hapësirën e përshtatshme për zhvillimin e seancave të ndërmjetësimit sipas parimeve të ndërmjetësimit, e cila është në kuadër të gjykatës;

Konflikti i interesit – nënkupton çfarëdo interes personal apo financiar në lidhje me kontestin, çfarëdo lidhje të mëhershme e drejtëpërdrejtë apo e tërthortë financiare, afariste, profesionale,

familjare ose shoqërore me cilëndo nga palët, gjë që mund të ndikojë në paanësinë e ndërmjetësuesit apo krijon përshtypjen e njëanshmërisë.

Dhunë në familje - është një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në: përdorimin e forcës fizike ose presionit psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes; çdo veprim tjetër i një anëtarit të familjes që mund të shkaktojë apo kanosë, se do të shkaktojë dhimbje fizike dhe vuajtje psikike; shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cënimin e dinjitetit; sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë, përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përuljes së personit tjetër, marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual, kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër, dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja se do ta bëjë këtë, vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike; hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesa e personit tjetër dhe rrëmbimi.

Marrëdhënie familjare – persona në marrëdhënie familjare konsiderohen personat që: janë të fejuar apo ishin të fejuar, janë të martuar apo ishin të martuar, janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore, që bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që kanë bashkëjetuar në një ekonomi të tillë, përdorin një shtëpi të përbashkët dhe janë në lidhje gjaku, martese, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, fëmijët, nipat, mbesat, vëllezërit dhe motrat, hallatë dhe tezet, xhaxhallarët dhe dajallarët ose kushërinjtë, janë prindër të një fëmije të përbashkët apo janë palë procedurale në një kontest nga marrëdhëniet familjare.

Neni 3 **Përshtatshmëria e lëndëve për ndërmjetësim**

1. Duke marrë parasysh natyrën e kontestit, interesin e palëve për të zgjidhur kontestin me marrëveshje, në kohë më të shkurtër dhe me më pak shpenzime, të gjitha lëndët civile ekzistuese të vjetra dhe të reja, sipas shqyrtimit dhe vlerësimit të gjykatës mund të konsiderohen të përshtatshme për referim në ndërmjetësim, me përjashtim të lëndëve nga paragrafi 6 i këtij neni.
2. Ndërmjetësimi i detyrueshëm zbatohet për kontestet nga marrëdhëniet familjare, lidhur me rastet nga alimentacioni, kujdestaria, kontaktet dhe mbajtja e fëmijës, ndarja e pronës së përbashkët martesore, kontestet pronësore që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet nga të drejtat e servituteve dhe kompensimi i pronës së shpronësuar.
3. Në rastet penale, ndërmjetësimi mund të zbatohet për veprat penale për të cilat parashihet dënim i gjallë ose/dhe me burgim deri në 3 (tri) vjet, duke marrë parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, nivelin e përgjegjësisë penale të tij, me përjashtim të lëndëve nga paragrafi 6 i këtij neni.
4. Personi recidivist i kryerjes së veprave penale nuk mund të zgjidh rast me ndërmjetësim më shumë se një herë.

5. Procedura e ndërmjetësimi për të miturit zhvillohet sipas procedurës së rregulluar me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

6. Procedura e ndërmjetësimit nuk zbatohet për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje, në pajtim me Ligjin kundër Dhunës në Familje ose për çdo mosmarrëveshje për të cilën është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent dhe ato që bien në kundërshtim me nenin 3.3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të Republikës së Kosovës.

Neni 4 **Referimi i lëndëve në ndërmjetësim**

1. Zyra për pranimin e parashtresave në gjykatë, pas regjistrimit të padisë si lëndë e veçantë i informon palët, përmes materialeve informuese (broshurave të ndyshme), për mundësinë e zgjidhjes së çështjes në ndërmjetësim.

2. Edhe gjyqtari në seancën përgatitore ose në shqyrtimin fillestar, pas vlerësimit të përshtatshmërisë së lëndës, informon palët se kanë mundësi që mosmarrëveshjen ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit.

3. Nëse palët japid pëlqimin për ndërmjetësim, gjyqtari merr vendim (Formulari 1) për referimin e lëndës dhe referenti për ndërmjetësim menaxhon me lëndën lidhur me përzgjedhjen e ndërmjetësuesit dhe seancat e ndërmjetësimit.

4. Nëse palët nuk japid pëlqimin për ndërmjetësim, varësish nga kush është referuar lënda, referenti plotëson Formularin nr. 7 dhe brenda 5 ditëve lëndën ia kthen Zyrës për pranimin e parashtresave ose gjyqtarit të çështjes për procedurë të mëtejshme.

5. Palët në çdo fazë të procedurës gjyqësore, mund ta njoftojnë gjyqtarin gojarisht apo përmes parashtresës, se dëshirojnë që lëndën e tyre ta zgjidhin përmes ndërmjetësimit. Në këto raste, pas vlerësimit të përshtatshmërisë, gjyqtari merr vendim (Formulari nr.1) për referimin e lëndës në ndërmjetësim.

Neni 5 **Referimi i lëndëve në ndërmjetësim të detyrueshëm**

1. Për lëndët si në nenin 3 paragraf 2 të kësaj rregullore, gjyqtari pas shqyrtimit paraprak të padisë, në seancën përgatitore, njofton dhe obligon palët që të provojnë ndërmjetësimin, me ç'rast merr vendim për referimin e lëndës në ndërmjetësim (Formulari 2), palët udhëzohen ta bëjnë përzgjedhjen e ndërmjetësuesit dhe lënda i dërgohet referentit për ndërmjetësim.

2. Nëse palët nuk dëshirojnë vet ta përzgjedhin ndërmjetësuesin, këtë e bënë referenti për ndërmjetësim i cili cakton ndërmjetësuesin sipas radhës së listës së ndërmjetësuesve të rajonit të asaj gjykate dhe cakton seancën për ndërmjetësim të detyrueshëm.

3. Nëse në këto lloje të kontesteve, gjyqtari vlerëson se ka elemente ose ekziston një histori e raportuar e dhunës në familje, atëherë bazuar në nenin 2 paragraf 3 të Ligjit për Ndërmjetësim, nuk e referon lëndën në ndërmjetësim të detyrueshëm dhe vazhdon me shqyrtimin e çështjes në procedurë gjyqësore.

4. Pas referimit të lëndës sipas paragrafit 1 të këtij neni, palët duhet të takohen të paktën një herë me ndërmjetësuesin brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve, nga dita e referimit të lëndës.

5. Palëve që kanë dështuar në ndërmjetësim të detyrueshëm, nuk iu mohohet e drejta që të kthehen në procedurë gjyqësore, duke prezantuar dëshmi me shkrim se kanë provuar ndërmjetësimin por pa sukses (Formulari nr.6).

Neni 6 **Menaxhimi i lëndës së referuar**

1.Pasi që gjykata e referon lëndën në ndërmjetësim, referenti për ndërmjetësim i ndërmerri këta hapa:

- a) E regjistron lëndën e referuar në Regjistrin e Lëndëve të Ndërmjetësimit me numër referues të ndërmjetësimit (Nd.nr.--/---);
- b) Kontakton palët në bazë të informacioneve kontaktuese që gjenden në shkresat e lëndës, për ditën në të cilën mund të vijnë për përzgjedhjen e ndërmjetësuesit. Nëse palët nuk dëshirojnë ta përzgjedhin vet ndërmjetësuesin, referenti cakton ndërmjetësuesin sipas radhës së listës së ndërmjetësuesve që mbulojnë rajonin e asaj gjykate. Nëse palët kanë përzgjedhur ndërmjetësuesin më herët, referenti i njofton palët për kohën e mbajtjes së seancës së ndërmjetësimit;
- c) Informon palët për procedurën, parimet, afatin ligjor, efektin juridik të marrëveshjes dhe informata tjera plotësuese
- d) Menaxhon me lëndët dhe orarin e seancave të ndërmjetësimit;
- e) Harton raportin mujor lidhur me ecurinë e lëndëve të referuara në ndërmjetësim dhe kujdeset për çështje tjera administrative që ndërlidhen me ndërmjetësim.

Neni 7 **Përzgjedhja e ndërmjetësuesit**

1.Referenti për ndërmjetësim iu ofron palëve mundësinë e përzgjedhjes së ndërmjetësuesit nga lista e ndërmjetësuesve të licencuar nga Ministria e Drejtësisë. Referenti e kontakton ndërmjetësuesin e përzgjedhur nga palët i cili duhet ta konfirmojë angazhimin e tij në lëndën e referuar brenda afatit prej tri (3) ditëve, në të kundërten referenti do të kontaktojë ndërmjetësues tjetër.

2. Nëse edhe ndërmjetësuesi tjetër nuk e konfirmon angazhimin e tij brenda afatit prej tri (3) ditësh nga dita e thirrjes, referenti për ndërmjetësim do ta caktoj ndërmjetësuesin tjetër sipas radhës nga lista e ndërmjetësuesve të rajonit që mbulon ajo gjykatë.

3.Nëse palët pajtohen, mund të angazhojnë dy ndërmjetësues në procesin e ndërmjetësimit (bashkëndërmjetësim).

Neni 8 **Fillimi i procedurës së ndërmjetësimit**

1.Para se të fillojë procedura e ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi duhet t'i informojë palët për parimet, rregullat, shpenzimet e procedurës dhe efektet juridike të marrëveshjes.

2. Procedura e ndërmjetësimit fillon në datën kur palët nënshkruajnë marrëveshjen me shkrim për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit (Formularin nr.3) dhe kanë 90 ditë për të arritur marrëveshje.

3. Nëse palët nuk mund të arrijnë marrëveshje brenda 90 ditëve, por ndërmjetësuesi vlerëson se marrëveshja mund të arrihet, atëherë ky i fundit me kërkesë të arsyetuar i drejtohet gjyqtarit që e ka referuar lëndën, për t'i lejuar një afat shtesë dhe të fundit prej tridhjetë (30) ditëve për zgjidhjen definitive të mosmarrëveshjes-kontestit në mes palëve.

4. Gjyqtari mund ta lejojë afatin e tillë shtesë, nëse nga kjo kohë shtesë nuk shkaktohen pasoja ligjore në humbjen ose fitimin e të drejtave për njérën palë.

Neni 9 **Marrëveshja për fillimin e ndërmjetësimit**

1. Marrëveshja për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit (Formulari 3) përmban këto të dhëna:

1.1 palët në procedurë ose përfaqësuesit e tyre

1.2 objektin e ndërmjetësimit

1.3 deklaratën e pranimit të ndërmjetësimit dhe

1.4 shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit dhe tarifën e ndërmjetësuesit

2. Në procedurën e ndërmjetësimit, personi fizik duhet të jetë i pranishëm personalisht apo përmes teknologjisë informative, ai mund të përfaqësohet nga personi i autorizuar, ndërsa personi juridik përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar me autorizim të posaçëm.

3. Kopjen e marrëveshjes të nënshkruar nga palët për fillimin e ndërmjetësimit, referenti ia dorëzon gjyqtarit i cili e ka referuar lëndën në ndërmjetësim, me qëllim të njoftimin të tij se procedura gjyqësore pezullohet, në kuptim të nenit 12 paragraf 1 të Ligjit për Ndërmjetësim, derisa të kaloj afati ligjor i ndërmjetësimit.

4. Seancat e ndërmjetësimit mbahen në ndërtesën e gjykatës. Përjashtimisht, nëse palët dhe ndërmjetësuesi pajtohen, seancat mund të mbahen edhe në objekte tjera të përshtatshme për ndërmjetësim por për këtë paraprakisht duhet të njoftohet gjykata përkatesishtë referenti për ndërmjetësim. Në këto raste, ndërmjetësuesi merr vetëm kopjet e shkresave të lëndës.

Neni 10 **Konflikti i interesit**

Në rastet e konfliktit të interesit, ndërmjetësuesi është i obliguar të veproj sipas dispozitës së nenit 18 të Ligjit për Ndërmjetësim dhe dispozitave tjera që rregullojnë fushëveprimtarinë e ndërmjetësuesit. Formulari 8.

Neni 11 Të metat e vullnetit

Pa marrë parasysh se në çfarë faze gjendet procedura e ndërmjetësimit, nëse ndërmjetësuesi vëren se në mes palëve ka elemente te dhunës në familje apo ka të meta në shprehjen e vullnetit të lirë të palëve përmes dhunës ose kanosjes, ndërmjetësuesi duhet ta ndërpres procedurën e ndërmjetësimit dhe të harton raport për arsyet e ndërprerjes dhe lëndën e kthen tek gjyqtari i çështjes për të vazhduar me procedurë gjyqësore.

Neni 12 Konfidencialiteti i informacioneve

1. Procedura e ndërmjetësimit është e natyrës konfidenciale, seancat e ndërmjetësimit janë jo publike dhe gjatë tyre nuk mbahet procesverbal.
2. Në seancat e ndërmjetësimit, përveç palëve ose përfaqësuesve të tyre, mund të marrin pjesë edhe persona të tretë vetëm me pëlqimin e palëve dhe ndërmjetësuesit.
3. Deklaratat dhe të gjitha informacionet tjera lidhur me procedurën e ndërmjetësimit nuk mund të përdoren si dëshmi në procedura tjetra, pa miratimin e palëve.

Neni 13 Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim

1. Marrëveshja në ndërmjetësim arrihet dhe varet ekskluzivisht nga vullneti i lirë i palëve.
2. Kur palët arrijnë marrëveshje, ndërmjetësuesi harton marrëveshjen me shkrim të cilën duhet ta nënshkruajnë palët dhe ndërmjetësuesi.
3. Marrëveshja është e detyrueshme për palët vetëm për objektin e marrëveshjes, por në raste të veçanta ka efekt juridik edhe ndaj personave të tretë dhe “*erga omnes*”
4. Marrëveshja duhet të jetë në pajtim legjislacionin në fuqi dhe e përshtatshme për përbirim.

Neni 14 Marrëveshja e ndërmjetësimit

1. Marrëveshja definitive e ndërmjetësimit Formulari nr.4 përbanë këto të dhëna:

- 1.1 emrin e gjykatës,
- 1.2 emrat e palëve në procedurë dhe emrat e të autorizuarve/përfaqësuesve të tyre (nëse kanë)
- 1.3 emrin e ndërmjetësuesit/ve,

- 1.4 tekstin e marrëveshjes së arritur lidhur me objektin e ndërmjetësimit,
- 1.5 nënshkrimet e palëve dhe të ndërmjetësuesit/ve,
- 1.6 datën dhe vandin e lidhjes së marrëveshjes,
- 1.7 miratimi nga ana e gjyqtarit (*me aktvendim të posaçëm apo me vendosjen e vulës së gjykatës*).

Neni 15 Mosarritja e marrëveshjes

Në rast se palët nuk arrijnë marrëveshje brenda afatit ligjor për ndërmjetësim, ndërmjetësuesi harton raport për arsyet e mosarritjes së marrëveshjes dhe e dorëzon tek referenti për ndërmjetësim, i cili pastaj ia dërgon gjyqtarit të çështjes, me qëllim të informimit se ai mund të vazhdojë me shqyrtimin e çështjes në procedurë të rregullt gjyqësore. Formulari 5

Neni 16 Përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit

1. Procedura e ndërmjetësimit përfundon me:
 - 1.1. arritjen e marrëveshjes në mes të palëve,
 - 1.2 mosarritjen marrëveshjes në mes palëve brenda afatit ligjor,
 - 1.3 tërheqjen e cilësdo palë, në çfarëdo kohe gjatë zhvillimit të procedurës dhe për shkak të mungesës së interesit juridik për vazhdimin e mëtejmë të procedurës së ndërmjetësimit
 - 1.4 kur ndërmjetësuesi vlerëson se vazhdimi i procedurës nuk është i arsyeshëm dhe
 - 1.5 për arsyet e njëjtë të përfundimit të procedurës- sikurse në procedure gjyqësore.

Neni 17 Efekti juridik i marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim

1. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim i dërgohet gjyqtarit të çështjes për miratim, i cili pas vlerësimit se marrëveshja i plotëson kriteret e parapara me legjisacionin në fuqi, me aktvendim të veçantë (Formulari 9) apo me vendosjen e vulës së gjykatës, e miraton të njëjtën, pas çka ajo e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe pas kësaj fiton edhe fuqinë e dokumentit përmbarues, në kuptim të dispozitave ligue në fuqi përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbarimore.

2. Klauzola e përmbarueshmërisë në marrëveshje vendoset sipas të njëjtave rregulla si në vendime të gjykatës.

3. Gjyqtari me aktvendim të veçantë anulon marrëveshjen e arritur me ndërmjetësim, kur konstaton se ajo është lidhur në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe kur pala dëshmon-argumenton se e njëjta është lidhur pa vullnetin e lirë dhe të plotë të saj.

4. Gjykata iu dorëzon palëve kopjen e verifikuar të marrëveshjes së miratuar nga ajo apo aktvendimin për anulimin e të njëjtës.

5. Kundër marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët nuk kanë të drejtë ankesë.

6. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedurë të veçantë gjyqësore.

**Neni 18
Dosja e lëndës**

1. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim nënshkruhet në tri (3) kopje, një për secilën palë dhe një bëhet pjesë e shkresave të lëndës së referuar dhe i dorëzohet gjyqtarit.

2. Formularët e tjera të procedurës së ndërmjetësimit bëhen pjesë e dosjes së lëndës gjyqësore.

3. Arkivimi i lëndës bëhet sipas procedurës së paraparë për arkivimin e lëndëve të gjykatës

**Neni 19
Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit**

Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit do të paguhen proporcionalisht nga palët, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe ashtu siç parashihet në Ligjin për Ndërmjetësim apo akte tjera nënligjore.

**Neni 20
Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.



Prishtinë,
Datë 08.05.2019

Aneks

FORMULARËT QË PËRDOREN NË PROCEDURËN E NDËRMJETËSIMIT

Formulari 1

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	Nr. i lëndës: _____
---	------------------------

Bazuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, Rregullores (Nr.--- --- për procedurën e ndërmjetësimit të lëndëve të gjykatave dhe pas vlerësimit të përshtatshmërisë së çështjes për tu referuar në ndërmjetësim, gjyqtari i çështjes me datën _____ merr këtë:

VENDIM

PËR REFERIMIN E RASTIT NË NDËRMJETËSIM

Me këtë vendim, obligohet referenti për ndërmjetësim i gjykatës, që në bazë të kompetencave ligjore që ka, të zhvilloj procedurat përkatëse për administrimin e rastit në procedurën e ndërmjetësimit.

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 i Ligjit për Ndërmjetësim gjykata bënë pezullimin e procedurës gjyqësore, deri sa të kaloj afati ligjor i ndërmjetësimit. Pezullimi i procedurës gjyqësore llogaritet nga data e nënshkrimit të marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit nga ana e palëve.

Në rastet kur palët nuk arrijnë marrëveshje në ndërmjetësim, gjykata vazhdon me trajtimin e çështjes në procedurë gjyqësore.

Gjyqtari: _____ (emri,mbiemri) _____ (nënshkrim)
Data e pranimit të lëndës nga referenti: _____

Formulari 2

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	Nr. i lëndës: _____
---	------------------------

Bazuar në nenin 9 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe kompetencave që i ka gjykata në bazë të këtij ligji si dhe Rregullores nr.--/---- për procedurën e ndërmjetësimit të lëndëve të gjykatave, gjyqtari i çështjes me datën _____, merr këtë:

VENDIM PËR REFERIMIN E RASTIT NË NDËRMJETËSIM TË DETYRUESHËM

Referenti për ndërmjetësim i gjykatës, lidhur me lëndën e referuar duhet që të zhvillojë procedurat përkatëse për administrimin e rastit në procedurën e ndërmjetësimit të detyrueshëm.

Bazuar në nenin 12 paragrafi 1 i Ligjit për Ndërmjetësim gjykata bënë pezullimin e procedurës gjyqësore, deri sa të kaloj afati ligjor i ndërmjetësimit. Pezullimi i procedurës gjyqësore llogaritet nga data e nënshkrimit të marrëveshjes për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit nga ana e palëve.

Në rastet kur palët nuk arrijnë marrëveshje në ndërmjetësim, gjykata vazhdon me trajtimin e çështjes në procedurë gjyqësore.

Gjyqtari: _____ (emri,mbiemri) _____ (nënshkrim)	
Data e pranimit të lëndës nga referenti: _____	

Formulari 3

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	MARRËVESHJE PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË NDËRMJETËSIMIT	Nr. i lëndës: _____ Nr. i lëndës në ndërmjetësim: <u>Nd.nr.</u> _____
---	--	---

Në bazë të nenit 11 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, me datën _____, në Gjykatën Themelore në _____, palët me emra si më poshtë pajtohen që të provojnë ndërmjetësimin.

Pala "A"	Pala "B"
Emri/mbiemri:	Emri/mbiemri:
Numri personal:	Numri personal:
Adresa e vendbanimit:	Adresa e vendbanimit:
Nr. tel.:	Nr.tel.:
Përfaqësuesi i Palës A (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel/natyra e përfaqësimit)	Përfaqësuesi i palës B (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel./natyra e përfaqësimit)
Objekti i kontestit: Vepra penale:	

Përmes kësaj marrëveshje, palët deklarojnë se:

- a) i kuptojnë parimet dhe procedurën e ndërmjetësimit dhe vullnetarisht pajtohen ta fillojnë këtë procedurë;
- b) procedura e ndërmjetësimit duhet të përfundojë brenda 90 ditëve nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshj. Nëse palët nuk mund të arrijnë marrëveshje brenda këtij afati, përmes ndërmjetësuesit mund t'i drejtohen gjyqtarit me kërkesë të arsyetuar për të zgjatur afatin përfundimtar edhe për tridhjetë (30) ditë të tjera, ashtu siç parashihet në Ligjin për ndërmjetësim
- c) e kuptojnë dhe pajtohen që të gjitha informatat e diskutuara gjatë procesit të ndërmjetësimit janë konfidenciale, ashtu siç parashihet në Ligjin për Ndërmjetësim;
- d) pajtohen që të përbahen nga ndonjë veprim tjetër juridik gjatë procedurës së ndërmjetësimit;
- e) janë informuar dhe i pranojnë shpenzimet e procedurës, përfshire tarifën e ndërmjetësuesit;
- f) pajtohen për ndërmjetësuesin e poshtëshënuar:

Ndërmjetësuesi: (emri/mbiemri,nr.tel)	Bashkëndërmjetësuesi: (emri/mbiemri,nr.tel)
Nënshkrimi i palëve (përfaqësuesve të palëve):	
Pala "A"	Pala "B"

Formulari 4

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	MARRËVESHJE E ARRITUR NË NDËRMJETËSIM	Nr. i lëndës: Nr. i lëndës në ndërmjetësim: <u>Nd.nr.</u>
---	--	---

Në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, me datën _____, në Gjykatën Themelore në _____, ndërmjet palëve me emra si më poshtë:

Pala “A” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr. tel.: Përfaqësuesi i Palës A (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel/natyra e përfaqësimit)	Pala “B” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr.tel.: Përfaqësuesi i palës B (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel./natyra e përfaqësimit)
Objekti i kontestit: Vepra penale:	

U arrit marrëveshje si në vijim:

Detyrat dhe përgjegjësitë (përdorni fletë shtesë nëse keni nevojë)	
Nënshkrimi i palëve dhe përfaqësuesve të tyre:	
Pala “A”	Pala “B”
Ndërmjetësuesi	Emri/mbiemri _____ nr.tel: _____ (Nënshkrimi)

Formulari 5

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	Nr.i lëndës: _____ Nr.i lëndës në ndërmjetësim: Nd.nr. _____
--	--

RAPORT I NDËRMJETËSUESIT PËR MOSARRITJEN E MARRËVESHJES NË NDËRMJETËSIM

Në bazë të nenit 17 të Ligjit nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, ndërmjet palëve të poshtëshënuara nuk u arrit marrëveshje për zgjidhjen e kontestit përmes ndërmjetësimit, andaj lënda me dokumentacionin e bashkëngjitur, i kthehet gjyqtarit përkatës për vazhdimin e procedurave ligjore në këtë rast.

Pala “A” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr. tel.: Përfaqësuesi i Palës A (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel/natyra e përfaqësimit)	Pala “B” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr.tel.: Përfaqësuesi i palës B (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel./natyra e përfaqësimit)
Objekti i kontestit Vepra penale	
Arsyetimi për moszgjidhjen	
Datat e seancave të ndërmjetësimit:	
Data e përpilimit të këtij raporti:	
Ndërmjetësuesi	Emri/mbiemri, _____ nr.tel: _____ (Nënshkrimi)

Formulari 6

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	Nr.i lëndës: _____ Nr.i lëndës në ndërmjetësim: Nd.nr. _____
---	--

RAPORT I NDËRMJETËSUESIT PËR MOSARRITJEN E MARRËVESHJES NË PROCEDURËN E NDËRMJETËSIMIT TË DETYRUESHËM

Në bazë të nenit 9 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, palët e poshtëshënuara kanë provuar ndërmjetësimin por kanë dështuar të zgjidhin mosmarrëveshjen-kontestin në Ndërmjetësim të Detyrueshëm.

Pala “A” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr. tel.:	Pala “B” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr.tel.:
Përfaqësuesi i Palës A (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel/natyra e përfaqësimit)	Përfaqësuesi i palës B (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel/natyra e përfaqësimit)
Objekti i kontestit:	

Lënda me dokumentacionin e bashkëngjitur, i kthehet gjyqtarit të çështjes për procedurë të mëtejahme.

Nënshkrimi i palëve dhe përfaqësuesve të tyre:	
Pala “A”	Pala “B”
Ndërmjetësuesi	Emri/mbiemri _____ nr.tel: _____ (Nënshkrimi)
Data e referimit të lëndës në ndërmjetësim:	
Datat e ndërmjetësimit:	Numri i orëve:
Data e kthimit të lëndës tek gjyqtari:	

Formulari nr.7

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	Nr.i lëndës: _____ Nr.i lëndës në ndërmjetësim: Nd.nr. _____
---	--

**RAPORT PËR MOSFILLIMIN
E PROCEDURËS SË NDËRMJETËSIMIT**

Pala “A” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr. tel.: Përfaqësuesi i Palës A (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel./natyra e përfaqësimit)	Pala “B” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr.tel.: Përfaqësuesi i palës B (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel./natyra e përfaqësimit)
Objekti I kontesit Vepra penale:	

Pas referimit të lëndës në ndërmjetësim, palët janë informuar lidhur me procedurën që mund ta ndjekin por kanë deklaruar se për arsyet e veta nuk dëshirojnë ta provojnë ndërmjetësimin.

Ky raport i bashkëngjitet shkresave të lëndës dhe i kthehet gjyqtarit për vazhdimin e procedurave ligjore.

Data e referimit të lëndës:	
Data e kthimit të lëndës tek gjyqtari:	
Referenti për ndërmjetësim:	 (Nënshkrimi)

Formulari nr. 8

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	Nr.i lëndës: _____ Nr.i lëndës në ndërmjetësim: <u>Nd.nr.</u> _____
--	---

**RAPORT I NDËRMJETËSUESIT NË RAST
KONFLIKTI TË INTERESIT**

Ndërmjetësuesi i rastit, në bazë të nenit 18 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dispozitave të Kodit të Etikës së Ndërmjetësuesve njofton palët me emra sim ë poshtë për paraqitjen e konfliktit të interesit në këtë rast.

Pala “A” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr. tel.:	Pala “B” Emri/mbiemri: Numri personal: Adresa e vendbanimit: Nr.tel.:
Përfaqësuesi i Palës A (nëse ka): (Emri/mbiemri/nr.tel./natyra e përfaqësimit)	
Vepra penale : Objekti i kontestit :	
Ndërmjetësuesi	Emri/mbiemri, nr.tel: _____ (Nënshkrimi)

Palët e kuptojnë paraqitjen e konfliktit të interesit dhe përmes këtij reporti deklarojnë si në vijim:

PO Palët dëshirojnë të vazhdojnë procedurën e ndërmjetësimit me ndërmjetësuesin e rastit, edhe pas njoftimit lidhur me natyrën e konfliktit të interesit.

Ose

JO Palët nuk dëshirojnë të vazhdojnë procedurën e ndërmjetësimit me ndërmjetësuesin e rastit, për shkak të paraqitjes së konfliktit të interesit.

Data: Nënshkrimi i palëve dhe përfaqësuesve të tyre:	
Pala “A”	Pala “B”

Formulari 9

Këshilli Gjyqësor i Kosovës Gjykata Themelore në _____ Dega _____	Nr. i lëndës : Nr. i lëndës në ndërmjetësim: Nd.nr._____
---	--

Bazuar në nenin 15 paragraf 1 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim dhe pas vlerësimit të marrëveshjes së palëve të arritur në ndërmjetësim, gjyqtari që ka referuar rastin, me datën _____ merr këtë:

AKTVENDIM

1. APROVOHET marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit në lëndën _____ dhe me numër të marrëveshjes ND.nr. _____ e arritur me datën _____.

2. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, e fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë dhe dokumentit përbartues sipas dispozitave ligjor në fuqi përfshirë këtuedhe dispozitat e Ligjit për Procedurën Përbartimore.

3. Vendimi iu dorëzohet palëve dhe kundër të njëjtit, sikurse edhe kundër marrëveshjes së arritur, palët nuk kanë të drejtë ankese.

4. Prishjen apo anulimin e marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim, palët kanë të drejtë ta kërkojnë vetëm me padi të veçantë në procedure të veçantë gjyqësore.

Gjyqtari :	_____ (emri/mbiemri) _____ (nënshtkrimi ose vula)
------------	--



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVË
SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
SEKRETARIATI / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

GJYKATA THEMELORE NË: _____, dega _____
C.nr: _____ / _____

P.nr. _____ / _____

Datë : _____ / _____ / 20_____

Bazuar në natyrën e kontestit tuaj që keni paraqitur në Gjykatën Themelore _____, dega _____, gjyqtari i çështjes ka vlerësuar se lënda juaj mund të jetë e përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit, andaj gjykata iu propozon dhe dërgon këtë:

FTESE PËR SEANCE TË NDËRMJETËSIMIT

Ftohet _____ nga _____
(emri/mbiemri) (adresa)

që me datën _____ në ora _____, të paraqitet në Zyrën për Ndërmjetësim nr. _____ në Gjykatën Themelore në _____, dega _____

Lidhur me çështjen juridike: _____ që të zgjidhni përmes ndërmjetësimit si procedurë alternative:

Pala- A: _____

Pala- B: _____

Në rast të mosardhjes suaj në këtë seancë, pa e arsyetuar mungesën, do të konsiderohet se nuk pajtoheni që të provoni të zgjidhni mosmarrëveshjen tuaj përmes Ndërmjetësimit. Andaj, lënda do të kthehet tek gjyqtari kompetent për të vazhduar procedurën e rregullt gjyqësore.

Referenti për Ndërmjetësim

Për më shumë informata, mund të kontaktoni në numrin e telefonit të kësaj gjykate: